

Shikojeni LIVE eklipsin diellor (Video)

Krijuar: Premte, 20 Mars 2015 10:17

Në Evropë dhe disa pjesë të Azisë dhe Afrikës do të ndodhë sot eklipsi diellor. Kjo dukuri ndodh kur Hëna kalon mes Tokës dhe Diellit, duke errësuar tërësisht ose pjesërisht imazhin e Diellit për shikuesit në Tokë.

Eklipsi i plotë do të jetë i dukshëm në ishujt Faroe të Danimarkës dhe në arkipelagun Svalbard të Norvegjisë.

Eklipsi do të fillojë në orën 9 e 37 minuta , maksimumi do të jetë në orën 10:45. ndërsa do të përfundojë në orën 11:56 minuta. Gjatë maksimumit do të shihen 43,5 për qind nga disku i Diellit.